

VENDIM
Nr. 229, datë 11.3.2015

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“PËR REHABILITIMIN DHE GJELBËRIMIN E ZONAVE PRANË
RRETHROTULLIMEVE DHE KRYQËZIMEVE NË SEGMENTIN RRUGOR
RROGOZHINË-FIER”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Për rehabilitimin dhe gjelbërimin e zonave pranë rrethrotullimeve dhe kryqëzimeve në segmentin rrugor Rrogozhinë-Fier”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për tokë “arë”, “truall” dhe “objekte”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 300 000 000 (treqind milionë) lekësh, nga të cilat:

a) tokë “arë” dhe “truall”, me sipërfaqe 16 197.8 (gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë pikë tetë) m² me vlerë 11 260 311 (njëmbëdhjetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë mijë e treqind e njëmbëdhjetë) lekë;

b) “objekte”, me vlerë 288 739 689 (dyqind e tetëdhjetë e tetë milionë e shtatëqind e tridhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për tokë “arë”, “truall” dhe “objekte”, prej 300 000 000 (treqind milionë) lekësh, të përballohet nga fondi i shpronësimeve, në llogarinë e shpronësimeve në Bankën e Shqipërisë, sipas përcaktimit të bërë në nenin 10, të ligjit nr.185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Shlyerja e pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi “Plotësim dokumentacioni dhe rikonfirmim”, të shlyhen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të bëjë shlyerjet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Kavajë, Lushnjë dhe Fier, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të shlyerjes, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Kavajë, Lushnjë dhe Fier të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Kavajë, Lushnjë dhe Fier për zbatimin e këtij vendimi.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela Nr.1

Lista e pronareve qe shpronsohen per ndertimet (objektet) nga "Rehabilitimi I zonave prane rrethrotullimeve dhe kryqezimeve segmenti Rrogozhine-Fier"

Rrethrrrotullimi	Nr.	Emri - Atësia - Mbiemri	Nr. Z. Kad.	Nr.Pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe ndërtimi	Lloji i objektit	Vlera (Lekë)	Shënime	
Rrogozhine	1	Rrahman Balliu	3235	490/65	Ndertese	1043	pike servisi dhe banimi 3 kate	28,112,302	Plot dok dhe rikonfirmim	
	2	Bashkepronaret Daja	3235	259/50	Ndertese	860	Magazine 2 kate	37,359,864	Plot dok dhe rikonfirmim	
	3	Llazar Angjeli	3235	259/54	Ndertese	870	Godine polifunksionale 2-3 kate	55,130,679	Plot dok dhe rikonfirmim	
Cerma	4	Ymer Kokja	1381	237/25	Ndertese	103	objekt 1 kat	3,851,774	Plot dok dhe rikonfirmim	
	5	Ymer Kokja	1381	237/54	Ndertese	236.8	Shtepi banimi dhe biznes	7,851,026	Plot dok dhe rikonfirmim	
	6	Kujtim Sako	3916	307/3	Ndertese	81	biznes 1 kat	1,955,035	Plot dok dhe rikonfirmim	
	7	Nazmi Muca	3916	503	Ndertese	380	ndertese karabina 4 kate	8,128,035	Plot dok dhe rikonfirmim	
	8	Sali Xhepa	1381	237/43	Ndertese	110	ndertese biznesi 2 kate	5,051,477	Plot dok dhe rikonfirmim	
	9	Rustem Kokja	3916	46/3	Ndertese	656	Ndertese 2 kate	22,619,223	Plot dok dhe rikonfirmim	
	10	Hasan Kokja	3916	44/2	Ndertese	125	ndertese biznesi servis	3,251,105	Plot dok dhe rikonfirmim	
	11	Shkelqim Kokja	3916	44/1	Ndertese	255	ndertese biznesi 2 kate	6,061,289	Plot dok dhe rikonfirmim	
	12	Haki Xhepa	3590	60/15	Ndertese	240	banese dhe karabina 2 kate	10,932,830	Plot dok dhe rikonfirmim	
	Grabian	13	Avni Harun Lila	1582	31/24	Ndertese	684	MAGAZINË + EKSPLOZITE 2-KATE	19,648,573	Plot dok dhe rikonfirmim
		14	Naim Ymer Lila	1582	31/26	Ndertese	406	MAGAZINË + EKSPLOZITE 2-KATE	11,764,410	Plot dok dhe rikonfirmim
		15	B/P . Xhepexhiu	1582	31/12	Ndertese	710	OBJEKT SHERBIMI 2-KATE	24,551,410	Plot dok dhe rikonfirmim
16		Kujtim Kaja	1582	31/23	Ndertese	630	OBJEKT SHERBIMI +BANIMI 3-KATESHE	42,470,657	Plot dok dhe rikonfirmim	
VLERA TOTALE								288,739,689		

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURES
SEKTORI I SHPRONESIMEVE
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Tabela Nr.2

Lista e pronareve qe shpronesohen per pasurite "Are" dhe "Truall" nga "Rehabilitimi I zonave prane rrethrotullimeve dhe kryqezimeve segmenti Rogozhine-Fier"

Rret	Nr.	Emri	Atesia	Mbiemri	Z.K.	Nr.Pas	Lloji I Pasurise	Sip.shpron/ m²	Cmimi Leke/m2	Vlera totale (ne leke)	Shenime
Rrogzhina	1	Rrahman		Balliu	3235	490/65	Truall	1240	366	453,840	Plot. Dok dhe rikonfirmim
	2	Ramazan	Selman	Daja	3235	259/52	Are	1278	345	440,910	Plot. Dok dhe rikonfirmim
	3	Sami	Selman	Daja	3235	259/53	Are	937	345	323,265	Plot. Dok dhe rikonfirmim
	4	Arif	Selman	Daja	3235	259/51	Are	935	345	322,575	Plot. Dok dhe rikonfirmim
	5	Llazar		Angjeli	3235	259/54	Truall	2998	366	1,097,268	Plot. Dok dhe rikonfirmim
	6	Hiqmet		Deda	3235	490/60	Are	1653	345	570,285	Plot. Dok dhe rikonfirmim
Cerna	7	Ymer		Kokja	1381	237/54	Truall	333.8	561	187,262	Plot. Dok dhe rikonfirmim
	8	Ymer		Kokja	1381	237/25	Truall	200	561	112,200	Plot. Dok dhe rikonfirmim
	9	Kujtim		Sako	1381	307/1	Truall	156	561	87,516	Plot. Dok dhe rikonfirmim
	10	Haki		Xhepa	3590	60/15	Truall	126	534	67,284	Plot. Dok dhe rikonfirmim
	11	Sali		Xhepa	1381	237/43	Truall	440	561	246,840	Plot. Dok dhe rikonfirmim
	12	Shkelqim		Kokja	3916	44/1	Truall	800	572	457,600	Plot. Dok dhe rikonfirmim
	13	Hasan		Kokja	3916	44/2	Truall	340	572	194,480	Plot. Dok dhe rikonfirmim
	14	Rustem		Kokja	3916	44/3	Truall	328	572	187,616	Plot. Dok dhe rikonfirmim
Grabian	15	Nazmi		Muca	3916	503	Truall	80	572	45,760	Plot. Dok dhe rikonfirmim
	16	Avni	Harun	Lila	1582	31/24	Truall	1020	2010	2,050,200	Plot. Dok dhe rikonfirmim
	17	Naim	Ymer	Lila	1582	315/44	Truall	406	2010	816,060	Plot. Dok dhe rikonfirmim
	18	Naim	Ymer	Lila	1582	315/44	Are	494	467	230,698	Plot. Dok dhe rikonfirmim
	19	Kujtim		Kaja	1583	261/23	Truall	1200	2010	2,412,000	Plot. Dok dhe rikonfirmim
	20	B/P		Xhepexhiu	1582	31/12	Truall	247	2010	496,190	Plot. Dok dhe rikonfirmim
	21	B/P		Xhepexhiu	1582		Are	986	467	460,462	Plot. Dok dhe rikonfirmim
VLERA TOTALE										11,260,311 Leke	